



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
DREJTORIA E KULTURËS,  
ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT**  
Nr. b660 Prot  
Shkodër, më 10. 6.2021

**ORGANIZATA KULTURORE  
“ANIFEST”**

### **MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

#### **AKTIVITET KULTUROR**

**“AniFestRozafa 2021”**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

**Bashkisë Shkodër me seli ligjore Rr. “13 Dhjetori”, Shkodër, përfaqësuar nga Znj. Voltana ADEMI në cilësinë e Titullarit të Institucionit,**

Dhe

**Organizata kulturore “AniFest ”, përfaqësuar ligjërisht nga z. Artan Marku.**

#### **BAZA LIGJORE:**

Ligji nr 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”



ALBANIA  
OJF. ANIFEST  
L06518L91V

Adresa: Tls. 13 Dhjetori, Nr. 1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

## **OBJEKTI:**

Bashkëpunim me qëllim zhvillimin e aktiviteteve kulturore në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

**Duke qenë se:**

**Bashkia Shkodër** ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore, nëpërmjet:

- ✓ Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë.
- ✓ Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor.
- ✓ Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar lokal si dhe zhvillimin e artit, kulturës, turizmit dhe promovimit të territorit.

***Palët bien dakort sa mëposhtë:***

## **QËLLIMI**

Organizata kulturore “Ani Fest” do të organizojë edicionin e 12-të “AniFestRozafa2021”.

Në këtë edicion do të shfaqen filmat finalistë nderkombëtarë në gjininë e filmit artistik me metrazh të shkurtër dhe filmit të animuar për grup mosha të ndryshme.

“Ani Fest Rozafa 2021” do të zhvillohet në Shirokë, në datat 09-13 Gusht 2021.

## **AFATI I MARRËVESHJES**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet nga palët me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, me afat nga data 09.08.2021 deri me 13.08.2021.

## **FORMA E BASHKËPUNIMIT**

Realizimi i aktivitetit kulturor “AniFestRozafa 2021”, duhet të permbushe protokollet e Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me situatën e shkaktuar nga Covid 19.



Promovimi i aktivitetit duhet te realizohet në media dhe në qytet përmes posterave, banerave etj, duke vënë në dukje bashkëpunimin me Bashkinë Shkodër.

## KOMUNIKIMI

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim.

## ZGJIDHJA E AKT MARRËVESHJES

Asnjëra nga palët nuk ka të drejtë të zgjidhë aktmarrëveshjen në mënyrë të njëanshme pa shkaqe të arsyeshme dhe para se të kenë njoftuar njëra - tjetrën me shkrim.

Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje apo kontraditë do të përpilen t'i zgjidhin me mirëkuptim.

Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së aktmarrëveshjes dhe procedurave juridike në fuqi, sipas legjislativit të Republikës së Shqipërisë.

## DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo akt marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo aktmarrëveshje u hartua në tre kopje, nga të cilat njëren e merr organizata kulturore "AniFest" ndërsa dy të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

PËR

BASHKINË SHKODËR

KRYETAR

Voltana ADEMI



ORGANIZATA KULTURORE  
"ANI FEST"

Artan MARKU

ALBANIA  
OJF ANIFEST  
100578191V



## Shirokë - Zona e lejuar për zhvillimin e aktivitetit



Sip. per shfrytëzim

DREJTORIA E STUDIMEVE, PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMIT TË INVESTIMEVE Ark. Aljon Koçkici